



**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
PROKURORIA E PERGJITHSHEME**

**URDHER**

**I**

**PROKURORIT TE PERGJITHSHEM  
Nr. 94. Date 16 .05. 2002**

**PER NDRYSHIMIN E URDHROT TE PROKURORIT TE PERGJITHSHEM  
NR.138, DATE 22.10.2001**

Per te evituar zvarritjet, per te rritur efektivitetin dhe kontrollin ne hetimet paraprake dhe meqenese nderprerja e hetimeve nuk justifikohet ligjesisht, ne mbeshtetje te neneve 8/2 dhe 9/2 te ligjit nr.8737, date 12.02.2001, "Per organizimin dhe funksionimin e Prokurorise ne Republiken e Shqiperise",

**URDHEROJ:**

1. Pika 6 e urdhrit nr. 138, date 22.10.2001, "Per krijimin e struktures per drejtimin e hetimeve ie procedimeve lidhur me grup veprash penale te renda" ndryshohet si vijon:

*Kur regjistohen procedime penale per njerem ose disa nga dispozikt e permendura ne piken 2 te ketij urdhri prokurorite e rretheve dergojne menjehere, por jo me vone se pese dite nga njoftimi i vepres penale, informacion te hollesishem ne Drejtorine e Krimet te Organizuar ne Prokurorine e Pergjithshme.*

*Per krime vecanerisht te renda dhe kur per kryerjen e ketyre veprave arrestohen ose ndalohen dy a me shume persona, njoftohet menjehere le telefon Drejtori i Drejtorise se Krimet te Organizuar dhe brenda pese ditene dergohet edhe informacion me shkrim.*

2. Urdheri te dergohet ne te gjitha prokurorite e rretheve.
3. Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

**PROKURORI I PERGJITHSHEM  
THEODHORI SOLLAKU**